



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2022:184233

Datë: 11.12.2023

Numri i dokumentit: 05045703

PPP.nr.63/2020

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA NË ISTOG, Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Pajtesë Boshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit K R U H. me seli në Pejë, ndaj debitorit Qajtore “Te V.”, me adresë në G.K numër 81 Komuna I., në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri me datën 29.02.2020 baza juridike borxh në shumë prej 2701,60 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat Blerim Baloku në Pejë P.nr.586/20 të datës 16.03.2020, jashtë seancës gjyqësore me datë 11.12.2023 bie këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET PJSËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit Qajtore “Te V.”, me adresë në G.K numër 81 Komuna I., i parashtruar kundër urdhrit të Përmbartuesit Blerim Baloku në Pejë P.nr. 586/20 të datës 16.03.2020, dhe atë për vlerën e borxhit në shumë prej 2,671.36 €.

II. REFUZOHET SI I PABAZUAR, prapësimi për pjesën tjetër të detyrimit në të holla në shumën prej 30.24 € të cilin detyrim në të holla obligohet pala debitore që ta përmbush ndaj kreditorit .

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi Urdhërohet që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh të paguaj garancinë në gjykatë në shumë prej 30.24 euro.

IV. Nëse debitori dështon të paguaj shumën e garancisë brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi, do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare nga pala ankuese.

A r s y e t i m

Kreditori, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit te Përmbartuesi Privat ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për

pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, për periudhën kohore nga data 01.01.2015 deri me datën 29.02.2020, baza juridike borxh në shumë prej 2701,60 €.

Përmbartuesi privat duke vendosur në bazë të propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin për përmbartim P.nr. 586/20 të datës 16.03.2020.

Debitori, në afatin e paraparë ligjor me datën 11.08.2020 ka parashtruar prapësim kundër këtij urdhri përmbartimor drejtuar kësaj gjykate duke u thirrur në parashkrimin e borxhit lëndorë sipas nenit 360 të LMD-së.

Kreditori nuk ka paraqitë përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit dhe vlerësimit të prapësimin të debitorit, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka konstatuar se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe atë për shumën e borxhit prej 2,671.36 euro, andaj vendosi si në pikën një të dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke ju referuar thënieve në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës ka konstatuar se borxhi lëndor i kërkuar nga kreditori nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2018 është i parashkruar dhe atë në shumë prej 2,671.36 €, e duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 360 par. 1 pika 1.1 dhe par. 2 të LMD-së (Ligji Nr. 04/L-077) i cili përcakton: *se kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, ndërsa afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë. Me dispozitën ligjore të nenin 71 të LPP-së është përcaktuar se: sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohej përmbartimi, me çka në rastin konkret është plotësuar kushti i ligjor material- prapësimor i paraparë me këtë dispozitë për të vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi. Ndërsa për pjesën tjetër të borxhit lëndor në shumë prej 30,24 €, e cila përfshin periudhën kohore nga data 31.01.2019 e deri me datë 29.02.2020, obligohet pala debitore që t'ia paguaj kreditorit, kërkesë kjo e cila nuk është parashkruar, për shkak se afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë, pa marr parasysh nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë. Prandaj gjykata vendosi si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktvendim duke e refuzuar prapësimin e debitorit sa i përket borxhit lëndor në shumë prej 30.24€ si të pabazuar në mungesë të provave materiale të cilat debitori nuk ia ka bashkangjitur prapësimin, ngase debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se është përmbushur detyrimi sipas faturave për vitin 2019 dhe 2020, e duke ju referuar nenit 69 par. 4 të LPP-së i cili shprehimisht përcakton se: *baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura, provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*, si dhe duke ju referuar nenit 29 par. pika 1.2 të LPP-së i cili*

shprehimisht përcakton se: *përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm, e dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është edhe ekstrakti i verifikuar nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave e në bazë të cilit është e ka mbështetjen ligjore urdhri për përmbartim.*

Gjykata i analizoi dhe shqyrtojë edhe pretendimet e tjera të debitorit të ushtruar me prapësim kundër propozimit për përmbartim të kreditorit, mirëpo nuk ua fali besimin sepse nuk ishin të mbështetura në prova relevante e as pretendimet e theksuara në prapësim nuk ishin të argumentuara, e duke pasur parasysh faktin se debitorit nuk ka ofruar ndonjë dëshmi se i njëjti ka paraqitur ndonjë ankesë ndaj kreditorit për faturën e lëshuar nga kreditori, gjykata ka gjetur se duhet vendosur si në dispozitat të këtij aktvendimi.

Gjykata lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancën gjyqësore, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 73 par. 1 të LPP-së i cili përcakton se: *gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përgjithimisht gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimin.*

Në pikën -III-, të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata ka urdhëruar debitorin, në rast se parashtrohet ankesë kundër këtij aktvendimi, në afatin prej 7 ditëve, në momentin e parashtrimit të ankesës të deponoj garancinë në gjykatë, në shumën e përcaktuar nga gjykata si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi dhe gjykatës t'ia dorëzoi provën për pagesën e garancionit, konform dispozitës ligjore të nenit 78 par.2 dhe 4 të LPP-së.

Andaj nga arsyet e theksuara me lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NE PEJË-DEGA NË ISTOG,

Departamenti i përgjithshëm - Divizioni Civil

PPP.nr.63/2020, datë 11.12.2023

G j y q t a r j a

Pajtesë Boshnjaku

UDHËZIMI JURIDK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes se të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.